

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#100

KUVEND/ Miratohen ndryshimet në ligjin për Agjencinë Kombëtare të Diasporës



Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ndryshimet në ligjin për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës me 88 vota pro, pesë kundër dhe pesë abstenim.

Ndryshimet e miratuara tashmë synojnë kryerjen e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin aktual, që lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, duke u mbështetur në zhvillimin e punës së Agjencisë dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit të legjislacionit gjatë këtyre viteve të funksionimit.

“Diskutimet e tepërta do të ishin jo të zakonshme për arsyen e thjeshtë se në diskutimet që ka pasur në Komisionin e Politikës së Jashtme për këto ndryshime të propozuara nga deputeti Adnor Shameti ka pasur konsensus të plotë”, tha në Kuvend ministri i Shtetit Pandeli Majko duke shtuar se ato përmirësojnë veprimtarinë administrative të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

QSPA/ Takimi në përkujtim të Pino Cacoza, flamurtarit të kulturës arbëreshe

Me nismën e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) dhe në bashkëpunim me Federatën e Shoqatave Arbëreshe (FAA), u organizua sot takimi online në përkujtim të personalitetit të njohur të kulturës arbëreshe Giuseppe (Pino) Cacoza, i cili u nga nga jeta muajin e shkuar për shkak të Covid-19.

Në këtë aktivitet të mbajtur me temën: “Pino Cacoza – Flamurtar i kulturës arbëreshe”, ishin të ftuar si kumtues kryesorë Damiano Guagliardi, kryetar i Federatës së Shoqatave Arbëreshe dhe studiuesi Francesco Marchianò, të dy miq të Cacozës, të cilët jo vetëm ndanë kujtime mbi miqësinë e hershme, por edhe treguan detaje nga jeta dhe personaliteti i tij shumëplanësh, pak i njohur për publikun dhe kryesisht me përmasën e kantautorit.



Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

QBD/ Falas online tekstet shkollore për Diasporën



Qendra e Botimeve për Diasporën vë në dispozicion falas për shkollat shqipe në Diasporë tekstin shkollore “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 2”. Teksti është hartuar në bazë të programit të miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë, për fëmijët shqiptarë që jetojnë jashtë kësaj Republike. Teksti është fitues i konkursit të shpallur nga kjo ministri, në vitin 2011 dhe është përgatitur për fëmijët e klasës I-III. Me anë të tij, fëmijët shqiptarë do të mësojnë të shkruajnë dhe lexojnë shqip; do të mësojnë për historinë e trashëgiminë kulturore të shqiptarëve etj.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"




Diaspora Shqiptare

SHKARKO
APLIKACIONIN FALAS

App store: këtu Play store: këtu

Dijitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen



CONNECT ALBANIA

Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online